




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN



VENDIM

Nr.4, datë 17.03.2022

PËR

MIRATIMIN E “KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN E LEJES SË PËRDORIMIT TË BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK”, NGA SUBJEKTI “DRINI BULOIZA” SH.P.K. TEK SUBJEKTI “GERTI” SH.P.K

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Shkumbin,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për transferimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik leja me nr.63/2 prot., datë 16/10/2017 dhe vendim nr.57 datë 10/10/2017 dhënë nga KBU Shkumbin nga poseduesi aktual subjekti “Drini Bulqizë”sh.p.k NUIS-K47220402N tek subjekti “Gerti”sh.p.k NUIS-J96829417K.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e veprës së marrjes 1 sipas KRGJSH

- $X=526242.1$; $Y=4579802.9$; $Z=1170$ m.m.n.d.

Vendndodhja e veprës së marrjes 2 sipas KRGJSH

- $X=525196.9$; $Y=4579986.8$; $Z=1170$ m.m.n.d.

Sasia e ujit e dhënë në përdorim $Q=0.52$ m³/sek.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBUSHKUMBIN

MAJLINDA PERRIU

